Kurbin/ Dy familje sherr me armë e sende të forta për tokën! Babë e bir plagosin 3 vëllezër, njërin e qëllojnë me armë, 2 të tjerë i dhunojnë fizikisht

Dy familje janë përfshirë në një konflikt familjar për cështje pronash që pasoi me përdorimin e dhunës e të armës në fshatin Fushë Milot të Kurbinit. Për pasojë një person është plagosur me armë, ndërsa dy të tjerë me sende të forta.

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton

Sh.com Redaksia
19 Gusht, 13:07 | Përditësimi: 19 Gusht, 15:07

Share

Kurbin- Dy familje janë përfshirë në një konflikt pronash që pasoi me përdorimin e dhunës e të armës në fshatin Fushë Milot të Kurbinit. Protagonistë janë dy vëllezër të familjes Murati dhe djali i njërit prej tyre, ndërsa viktima kanë mbetur 3 vëllezërit e familjes Veseli. Njëri prej tyre është plagosur me armë, ndërsa dy të tjerë me sende të forta.

Mësohet se e 3 vëllezërit Veseli kanë qenë duke puunuar tokën kur u janë afruar Sokol e Pëllumb Murati dhe djali i Sokolit, Valdano Murati 32 vjeç. Ata kanë debatuar fillimisht dhe më pas janë konflikturar me sende të forta.

> *"Nga veprimet e para në vendngjarje rezultoi se në konflikt ishin përfshirë dy familje, për motive pronësie. Konflikti kishte nisur fillimisht me sende të forta dhe më pas në përdorim të armës së zjarrit. Shtetasi Sokol Murati dhe Pëllumb Murati ishin konflikturar me sende të forta për motive pronësie me tre vëllezërit shtetasit Y. V., S. V. dhe E. V. Si pasojë e konfliktit janë dëmtuar me sende të forta shtetasit Y. V. dhe S. V., si dhe është plagosur me armë zjarri shtetasi E. V. (të tre vëllezër)" informoi sot policia e Lezhës.*

Sh.com
LEXO EDHE:
Marrëveshja me Italinë, më 1 shtator hapen kampet për emigrantët, sot testi i fundit! 500 karabinierë zbresin në Shëngjin e Gjadër

Me të mësuar sherrin në ndihmë të policisë së Lezhës kanë shkuar dhe forcat e sigurisë së Shkodrës, që kanë bërë të mundur kapjen, shoqërimin në Komisariat dhe arrestimin e dy vëllezëve Murati si dhe kanë shpallur në kërkim shtetasin Valdano Murati 32 vjeç djali i të arrestuarit, Sokol Murati.

Gjatë kontrollit në banesën e Sokol Muratit, policia gjeti dhe sekuestroi në cilësinë e provës materiale një sasi municioni luftarak.

Lajmi ne perditesim...

S.G/E.H/Shqiptarja.com

TAG: Kurbin | Lezhe | Valdano Murati | Sokol Murati

Komento

Komente

Greta: 19/08/2024 23:49

Nuk jan te verteta ato ce ju kan treguar shkoni pytni te tjer se esht gjynah ti hyni ne hak njerzve ato ju kan hy ne bane duke i kercenuar ju lutem mos me besoni po shkoni dhe informohuni me mir

Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës:
Kredimarrësit e këqinj s'do marrin më kredi, si e vlerësoni rregulloren e BSH?

Të mirë | Të keqe | Nuk e di

Lajme të tjera

Vritet 68-vjeçari në Mirditë, qëllohet me breshëri plumbash nga dritarja e dhomës ku flinte! E bija e gjen të vdekur pas 2 ditësh (FOTO)
20 Gusht, 08:35

Aksident tragjik në aksin Lezhë-Shëngjin, makina humb drejtimin nga shpejtësia e lartë! Ndërron jetë i riu
20 Gusht, 08:07

Lezhë/ Makina godet autobuzin e linjës Shkodër- Tiranë! Mjeti më pas përplaset nga një kamion
19 Gusht, 17:47

Lezhë, 24 vjeçari përplas me makinë 72 vjeçaren, e moshuara vdes
19 Gusht, 13:39

Marrëveshja me Italinë, më 1 shtator hapen kampet për emigrantët, nesër testi i fundit! 500 karabinierë zbresin në Shëngjin e Gjadër
19 Gusht, 10:07

Kurbin/ Me motor pa targa dhe i armatosur po shkonte të vriste kushëririn e tij, arrestohet 53-vjeçari (EMRI+VIDEO)
18 Gusht, 10:40

Pasuroi kulturën shqipe! Del në dritë vepra letrare e klerikut Don Jak Zekaj

Elvis Hila

17 Gusht, 16:41

Lezhë/ Kapet në mes të pyllit duke kultivuar kanabis, asgjësohen 250 bimë! Arrestohet 43-vjeçari
17 Gusht, 10:54

"Shtegtarët" shqiptarë, emocione në qytetin e lindjes! Festë mirënjohjeje në Lezhë

Elvis Hila

16 Gusht, 13:03



Pamjet/ Droni e kap 'mat' teksa kujdesej për plantacionin e kanabisit në pyjet e Kaçinarit, arrestohet! Ikën bashkëpunëtori, nën akuzë kryeplaku e 2 specialistë
16 Gusht, 11:17

Aksident në aksin Lezhë-Shkodër, mjeti përplaset me barrierat metalike! Shoferi në spital
16 Gusht, 07:43

Marrëveshja me Italinë për emigrantët, UNHCR do të monitorojë kampet në Shëngjin
15 Gusht, 17:25

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje